



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA**  
**MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

Sipas marrëveshjes me Ambasadën e Britanisë së Madhe në Prishtinë, që mbështet financiarisht projektin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) "Mbështetje për administrimin efektiv dhe efikas të fondeve nacionale të bujqësisë në Kosovë", si dhe në pajtim me Nenin 10, pika 2.2 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03/L-212), MBPZHR,

**SHPALL KONKURS**

Për këto vende pune: Me afat të caktuar nga data **17.08.2015 deri më 29.02.2016**

**I. Titulli i punës:** Inspektor Teknik, dy (2) vende  
**Njësia organizative:** Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë  
Divizioni i Inspektoriatit në AZHB  
**Kategoria funksionale:** Nivel profesional  
**Vendi i punës:** Prishtinë  
**Ref:** DFSHP 11.1/ 411 /2015

**Paga mujore:** 475.53 Euro (bruto)

Nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të shefit të Divizionit të Inspektimit , duhet t'i ushtrojë këto **detyra dhe përgjegjësi:**

1. Shqyrtimi dhe përgatitja e dokumentacionit të dosjeve që do të kontrollohen në terren, përgatitja e listave të kontrollit (check lista) dhe raportet e kontrollit 15%;
2. Kontrolli në terren i projekteve të zhvillimit rural (ZHR) sipas programit nacional dhe IPA (Para miratimit, pas kërkesës për pagesë dhe pas finalizimit të investimit ne afat prej 3 viteve ) 20 %;
3. Kontrolli në vend ngjarje i aplikacioneve për Pagesa Direkte 20%;
4. Analizimi dhe argumentimi i rezultateve të kontrolleve dhe përgatitja e raportit të kontrollit 15%;
5. Zbatimi i procedurave të kontrollit në teren 10 %;
6. Pjesëmarrje në trajnime, seminare në kuadrin e implementimit të programit IPA, programit nacional për ZHR dhe PD 5 %;
7. Raporton për kontrollet e kryera 10 %;
8. Kryen detyra te tjera sipas urdhrave të eprorit 5%.

**Qëllimi i vendit të punës:**

Kontrolli në vend ngjarje i projekteve të ZHR sipas programit nacional dhe IPA si dhe për Pagesa Direkte. Të paraqet realitetin e investimit të bërë nga aplikuesi, analizon dhe argumenton rezultatet e kontrolleve të kryera dhe përgatit raportet e kontrollit.

**13 .Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:** *(kualifikimet, përvoja, shkathtësitë dhe aftësitë e kërkua për këtë vend pune)*

- Njohuri dhe përvojë substanciale në kompjuter dhe programe softverike (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri për procedurat e inspektimit;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me mbështetjen në bujqësi dhe zhvillim rural;
- Shkathtësi në komunikim dhe punë ekipore;
- Diplomë universitare në drejtimet: bujqësi, ekonomi, siguri ushqimore, veterinari, menaxhment, juridik ose administrim biznesi;
- Përvojë pune: Së paku një vit.

---

**I. Titulli i punës: Zyrtar për Pagesa Direkte, tre (3) vende**

**Njësia organizative: Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë**

**Vendi i punës: Prishtinë**

**Paga mujore 475.53 Euro (bruto)**

Nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Shefit të Divizionit për Pagesa Direkte, duhet t'i ushtrojë këto **detyra dhe përgjegjësi:**

1. Pranimi i aplikacioneve për Pagesa Direkte dhe futja e të dhënave në program; 20 %;
2. Shpërndarja e informatave për procesin e aplikimit; 20 %;
3. Grumbullimi dhe sistemimi i aplikacioneve sipas masave të Pagesa Direkte; 15 %;
4. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve sipas nen-masave, 15 %;
5. Hartimi i listave të kontrollit administrative 5 %;
6. Vlerësimi i raporteve të kontrollit në vend ngjarje 10 %;
7. Përdorimi i programit eFR dhe grant menaxhment 10 %;
8. Punë tjera me urdhër të eprorit 5 %.

**Qëllimi i vendit të punës:**

Është përgjegjës për grumbullimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve për pagesa direkte.

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:** *(kualifikimet, përvoja, shkathtësitë dhe aftësitë e kërkua për këtë vend pune)*

- Njohuri dhe përvojë substanciale në kompjuter dhe programe softverike (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me mbështetjen në bujqësi dhe zhvillim rural;
- Shkathtësi në komunikim dhe punë ekipore;
- Diplomë universitare në drejtimet: bujqësi, ekonomi, siguri ushqimore, veterinari, menaxhment, juridik ose administrim biznesi;
- Përvojë pune: Së paku një vit

---

**Data e publikimit:** 05.08.2015

**Data e mbylljes:** 11.08.2015

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen. Dokumentet duhet të jenë fotokopje, përndryshe nuk kthehen.

**Procedura e Aplikimit:** Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Divizionit e Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ndërtesa e Ish Partive Politike në Prishtinë, nr.237 - 241 kati II zona C.